

URDHËR
Nr. 315, datë 13.9.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”, nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; në VKM-në nr. 870, datë 14.12.2021, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të autoritetit kontraktor, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore të institucionit.
2. Për nënshkrimin e autorizimeve për dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, jashtë qendrës së punës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në largësi mbi 100 km si dhe jashtë vendit.
3. Nënshkrimin e kontratave administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.
5. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.
6. Urdhri nr. 14, datë 16.1.2023, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani